



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, nenit 2 të Rregullores së Kuvendit të Komunës 15Nr.110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimin e Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit Nr.15-400/01-27009 i datës 29.05.2025, duke u bazuar edhe në Kërkesën e Sektorit për punë të Kuvendit dhe Komiteteve të datës 25.08.2025 i Komunes nxjerr këtë:

#### VENDIM

#### PËR EKZEKUTIMIN E PAGESËS PËR SUBVENCIONIMIN E AKTIVITETEVE TË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE DHE LAGJEVE URBANE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

**I.OBLIGOHET**, Drejtorati për Buxhet dhe Financa të bëjë ekzekutimin e pagesës në shumë prej 27,000.00 € (njëzet e shtatë mijë euro) duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-400/01-27009 i datës 29.05.2025 për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit për subvencionimin e aktiviteteve të kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit për 54 (pesëdhjetë e katër) kryetarë/e me nga 500 € për secilin sipas tabelës vijuese:

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Vendbanimi  | Numri i xhirollogarisë | Banka           | Shuma |
|----|------------------|-------------|------------------------|-----------------|-------|
| 1. | MUHARREM LATIFI  | LELETIQ     | 1300003009840442       | BPB             | 500 € |
| 2. | SINAN QERIQI     | KROJMIR     | 2026000086913036       | TEB             | 500 € |
| 3. | ASLLAN THAQI     | VRELLË      | 1401000014075946       | Banka Ekonomike | 500 € |
| 4. | BESIM SEFERI     | GUMNASSELLË | 2026000238022934       | TEB             | 500 € |
| 5. | BEHAR KRASNIQI   | TOPLIQAN    | 2416110700188689       | Pri Bank        | 500 € |
| 6. | XHELAL KRASNIQI  | TEQE        | 1401000010277620       | Banka Ekonomike | 500 € |
| 7. | MILAZIM SHALA    | KLEQKË      | 2023000083214673       | TEB             | 500 € |
| 8. | GËZIM BYTYÇI     | LIPJAN      | 1907537855321148       | BKT             | 500 € |

|     |                   |                     |                  |                 |       |
|-----|-------------------|---------------------|------------------|-----------------|-------|
| 9.  | BEXHET KONXHELI   | TEQE                | 1300003504186392 | BPB             | 500 € |
| 10. | HAKI SHALA        | VRELLË E GOLESHIT   | 1701003217833303 | NLB Bank        | 500 € |
| 11. | ILAZ BEDROLI      | QELLOPEK            | 1907728953021105 | BKT             | 500 € |
| 12. | GENTRIT SINANI    | RESINOC             | 1501080002709041 | Raiffeisen Bank | 500 € |
| 13. | MUSTAF REXHEPI    | GADIME E EPERME     | 1701003022379661 | NLB Bank        | 500 € |
| 14. | SHEREMET KOLSHI   | BAICË               | 2026000037257669 | TEB             | 500 € |
| 15. | LIRIM DRAGAQINA   | BUJAN               | 1501090003609152 | Raiffeisen Bank | 500 € |
| 16. | BESNIK JASHARI    | DOBRAJË E VOGEL     | 1300003017923743 | BPB             | 500 € |
| 17. | AHMET ZEQRIRI     | HALLAQ I VOGEL      | 1501080002768987 | Raiffeisen Bank | 500 € |
| 18. | KAMER PODRIMQAKU  | LIPJAN              | 1501001006217695 | Raiffeisen Bank | 500 € |
| 19. | AGRON GORANI      | RUFC I RI           | 2026000051137302 | TEB             | 500 € |
| 20. | AGRON ZEQRIRI     | HALLAQ I MADH       | 1300003010596072 | BPB             | 500 € |
| 21. | GAZMEND SYLEJMANI | KONJUH              | 2026000124100896 | TEB             | 500 € |
| 22. | MURAT GERBESHI    | SLLOVI              | 1701018604983461 | NLB Bank        | 500 € |
| 23. | XHYLA KARPUI      | SHALË               | 2026000096755820 | TEB             | 500 € |
| 24. | VALMIR KRASNIQI   | ZLLAKUQAN           | 2026000237758124 | TEB             | 500 € |
| 25. | SKENDER GASHI     | DOBRAJË E MADHE     | 1401000015424537 | Banka Ekonomike | 500 € |
| 26. | NIJAZI SLLAMNIKU  | TOPLIQAN            | 2026000010478879 | TEB             | 500 € |
| 27. | MILAIM XHEMA      | GRACKË E VJETER     | 1907003978021121 | BKT             | 500 € |
| 28. | MUHARREM GASHI    | AKLLAP              | 1501080002241404 | Raiffeisen Bank | 500 € |
| 29. | VALON MAREVCI     | MAREVC              | 1407000070654388 | Banka Ekonomike | 500 € |
| 30. | MEHDI AVDYLI      | BREG I ZI           | 1300004200145484 | BPB             | 500 € |
| 31. | BLEART PLLANA     | GLLANICË            | 2021000218498054 | TEB             | 500 € |
| 32. | BARDHYL IBRAHIMI  | GLLOGOC             | 1305003012522533 | BPB             | 500 € |
| 33. | ABEDIN ILAZI      | TORINË              | 2026000237703707 | TEB             | 500 € |
| 34. | AFRIM HAJRULLAHU  | BANULLË             | 1507001000763570 | Raiffeisen Bank | 500 € |
| 35. | ARMEND MAGJERI    | KOJSKË              | 2014000191095710 | TEB             | 500 € |
| 36. | SMAJL SHABANI     | POTUROC             | 1902272350321151 | BKT             | 500 € |
| 37. | NASER DUHLAKU     | VËRSHEC             | 2026000026915335 | TEB             | 500 € |
| 38. | IDRIZ SOPA        | BABUSH I MUHAXHERVE | 1907507443321167 | BKT             | 500 € |



|     |                 |                                                                           |                  |                 |       |
|-----|-----------------|---------------------------------------------------------------------------|------------------|-----------------|-------|
| 39. | QERIM FAZLIJA   | MIRENË                                                                    | 1401000013987676 | Banka Ekonomike | 500 € |
| 40. | ISMET AHMETI    | RUFC I VJETER                                                             | 1701018500646672 | NLB Bank        | 500 € |
| 41. | ALI SOPA        | GRACKË E VOGEL                                                            | 1907413936021216 | BKT             | 500 € |
| 42. | ALI TMAVA       | LLUGAXHI                                                                  | 2026000008681566 | TEB             | 500 € |
| 43. | NAIM REÇICA     | GLLAVICË                                                                  | 2026000050329971 | TEB             | 500 € |
| 44. | JOVICA MIRIČ    | Lipjan -Naselje kod Crkve                                                 | 1401000011762496 | Banka Ekonomike | 500 € |
| 45. | RAMIZ GASHI     | MAGURË                                                                    | 1501080002632314 | Raiffeisen Bank | 500 € |
| 46. | IMRI LACAJ      | KRAISHTË                                                                  | 1501080002556169 | Raiffeisen Bank | 500 € |
| 47. | GEZIM BYTYQI    | QYLAGË                                                                    | 2013000004090915 | TEB             | 500 € |
| 48. | SYLEJMAN BLLACA | RIBAR I MADH                                                              | 1501080000887769 | Raiffeisen Bank | 500 € |
| 49. | ZYMER AHMETI    | Lipjan -Lagjia e Akllapit                                                 | 2026000051794671 | TEB             | 500 € |
| 50. | NESRET KELMENDI | RIBAR I VOGËL                                                             | 1300003017952358 | BPB             | 500 € |
| 51. | RINOR REÇICA    | RUBOVC                                                                    | 2026000259938047 | TEB             | 500 € |
| 52. | NAZMI KRASNIQI  | LLUGË                                                                     | 2026000007865796 | TEB             | 500 € |
| 53. | KUJTIM ALIU     | GADIME E ULËT                                                             | 1907000327021146 | BKT             | 500 € |
| 54. | TON GASHI       | BRUS (sipas Autorizimit noterial të dhënë Kryetari i fshatit Engji Gashi) | 1501080001993278 | Raiffeisen Bank | 500 € |

II. Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogaritë bankare të tyre.

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti i dërgohet për zbatim Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400/01-48192

Lipjan, më 25.08.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par. 4 dhe 5 i Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore ,nenit 72A të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar), neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Kërkesën e Drejtorit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari të datës 05.08.2025, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT AD.HOC PËR PRANIMIN E PASURISË JO**  
**FINANCIARE –FURNIZIMEVE, SHËRBIMEVE DHE PUNËVE**

**Neni 1**

**Përbërja e Komisionit**

Për pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve,formoj Komisionin ad.hoc për projektin e serave, sipas kontratës me numër 613-25-4434-1-2-1/C1090 ,në këtë përbërje:

1. Afrim Sadiku, Kryesues
2. Rrahim Krasniqi, anëtar
3. Shefki Sadiku, anëtar

**Neni 2**

**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni në pajtim me dispozitat e Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar) bën pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për projektin e serave, sipas kontratës me numër 613-25-4434-1-2-1/C1090 dhe gjatë pranimit ka për detyrë si vijon :

1. Të verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në përputhshmëri me kontratën për urdhërblërgjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në përputhje me kontratën dhe urdhërblërgjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimit të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimit të pasurisë jofinanciare shënon edhe arsyetimin e mospranimit.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-40794  
Lipjan, më 05.08.2025

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1**  
**Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike “Plani i Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 në Komunën e Lipjanit Nr.05-453/01-385010 të datës 28.07.2025, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Agnesa Terpeza nga OJQ-të anëtare
5. Majlinda Krasniqi, në cilësinë e ekspertes të jashtëme, anëtare
6. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtarë rezervë

**Neni 2**  
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike „ Plani i Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 në Komunën e Lipjanit Nr.05-453/01-385010 të datës 28.07.2025 ,të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t’i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-47011  
Lipjan, më 20.08.2025

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1  
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –Klubeve sportive që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-40815 të datës 05.08.2025, në përbërje si vijon:

1. Trimor Shamolli, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
3. Besmir Retkoceri, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtar
4. Leotrim Pajaziti, nga OJQ-të, anëtar
5. Bahri Limolli, në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtar dhe
6. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar rezervë

**Neni 2  
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve - Klubeve Sportive që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-40815 të datës 05.08.2025 të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3  
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-48801  
Lipjan, më 26.08.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

### **VENDIM**

### **PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT**

#### **Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **10,080.00€**, (dhjetëmijë e tetëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-40142 e datës 04.08.2025, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 36 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin korrik të vitit 2025 me nga 280 euro për secilin rast  $36 \times 280 = 10,080.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

#### **Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhironlogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

#### **Neni 3**

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

#### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-40142  
Lipjan, më 05.08.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

